



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 11586 Prot.

Vlorë, më 15.07. 2025

VENDIM

Nr 8, datë 15.07.2025

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Neni 17; 53, pika 2 dhe 4; 56, pika 2; dhe Rregulloren “Për Organizmin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” neni 58, 59, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 15.07.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 21.07.2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 11587 Prot

Vlorë, më 15.07 2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë, datë 21.07.2025.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE

PREFEKTIT TË QARKUT VLORE

Ju njoftoj se, **ditën e hënë , datë 21.07.2025, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas ;

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 26.06.2025.
2. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 46 - 61, datë 26.06.2025;

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin Qershor 2025”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025”.
3. Projektvendim “Për miratimin e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe, vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”
4. Projektvendim “Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara”
5. Projektvendim “Për nisjen e procedurës për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjet me të drejtë rinovimi të sipërfaqes kullimore që bën pjesë në ekonominë Shashicë-Gumenicë, ngastra 3 me sipërfaqe 48.8 ha, nr.serial 262, datë 08.05.2023, ngastra 4 me sipërfaqe 104.25 ha nr.serial 256, datë 05.05.2023, ngastra 8 me sipërfaqe 410.43 ha nr.serial 257, datë 05.05.2023, ngastra 9 me sipërfaqe 145.53 ha me nr.serial 258

,datë 05.05.2023, ngastra 10 nr. Serial 259, datë 05.05.2023 me sipërfaqe 122.54 ha, për veprimtari fotovoltaike “

6. Projektvendim “Për shprehjen e dakordësisë për nisjen e procedurave për transferimin e disa pasurive në pronësi të Bashkisë Vlorë” pasurisë nr. 32/107, sip 390 m², zk. 8604; pasurisë nr. 32/524/1, sipërfaqe totale 552 m², zk. 8604; pasurisë nr. 32/399, sip 32833 m², zk. 8604; pasurisë nr. 32/106, sip 390 m², zk. 8604 pasurisë 32/90, sip 503m2/zk 8604, pasurisë 32/91,sip 503.2m2, zk8604,pasurisë 32/92, sip 503m2 zk8604 ,pasurisë nr.32/103 , sip 390m2, zk 8604, pasurisë nr.32/104 , sip 375 m2, zk 8604, pasurisë nr.32/105 , sip 390m2, zk 8604, pasurisë nr.32/524/1 , sip 552 m2, zk 8604, pasurisë nr.27/181 , sip 480 m2, zk 8604, pasurisë nr. 27/174, sip 127 m², zk. 8604, pasurisë nr. 27/176, sip 380 m², zk. 8604; pasurisë nr. 27/178, sip 420 m², zk.8604; pasurisë nr. 27/293, sip 105 m², zk 8604.
7. Informacion mbi raportin statistikor të punës dhe vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën 1 Janar – 30 Qershor 2025.
8. Të ndryshme.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, do të mbledhet në mjediset e Bashkisë Vlorë, ditën e martë , datë 15.07.2025, ora 11:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e enjte , datë 17.07.2025 , ora 09:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e enjte, datë 17.07.2025, ora 10:00.

Komisioni i shërbimeve publike,transportit,infrastrukturës dhe strehimit do të mbledhet ditën e enjte, datë 17.07.2025, ora 11:00.

Komisioni për zhvillimin urbanistik dhe ndërtimet, do të mbledhet ditën e enjte, datë 17.07.2025, ora 12:00.

Komisioni i bujqësisë, pyjeve, dhe menaxhimit të ujrave, do të mbledhet ditën e enjte, datë 17.07.2025, ora 13:00.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri

